



V E N D I M
NR.1 I ASAMBLESE SE ORTAKEVE.

Ne Vrion te Sarandes sot me daten 23.08.1996, me njoftimin e administratorit dhe ortakut Panajotis Andoniadhis u thirr mbledhja e jashtezakonshme e Asamblese se ortakeve te shoqerise "SUPERBETON"SH.P.K.

Ne mbledhje moren pjese te tre ortaket ; Emanuel Vardhallaqis, Nikollaos Andonopullos dhe Panajotis Andoniadhis.

Rendi i dites i mbledhjes se Asamblese se ortakeve eshte :

-Mbi ndryshimet ne aktet e themelimit te shoqerise nga blerja e pjeses se kapitalit shteteror ne shoqerine "SUPERBETON"SH.P.K. si dhe mbi transferimin(shitjen) e pjeses se kapitalit shteteror zotit Sotiraq Marjani.

Mbasi u diskutua prej te gjithë ortakëve rezultoj se ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.288 date 5/06/1996, Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.552 date 16/10/1995 (Per privatizimin e kapitalit shteteror te shoqerise "SUPERBETON"), te autorizimit te Agjencise Kombetare te Privatizimit nr.1473 date 22/04/1996 si dhe kontrates se shitjes te dates 15/07/1996 eshte blere nga ana jone kapitali shteteror i shoqerise "SUPERBETON" Sarande.

Te tre ortaket mbasi diskutuan ne unanimitet vendosen qe kuotat e kapitalit shteteror ne shumen 13.653.500 leke qe perfaqesojne 45% te kapitalit te pergjithshem aktual te shoqerise qe eshte 29.741.000 leke tjaja transferojne (shesin) zotit Sotiraq Marjani i cili ka kerkuar blerjen e ketyre kuotave prej nesh.

Te tre ortaket ne zbatim te procedures per privatizimin e ndermarrjeve te perbashketa vendosen te ulin kapitalin fillestar nga shuma 39.195.000 leke ne shumen 29.741.000 leke.

Ortaket rana dakorte qe administrator te shoqerise te jene zoti Panajotis Andoniadhis dhe ortaku i ri Sotiraq Marjani.

Persa me siper Asambleja e ortakeve

V E N D O S I :

1-Te uli vleren e kapitalit te pergjithshem fillestar te shoqerise nga shuma 39.195.000 leke ne shumen 29.741.000 leke.

2-Te transferoje(shese) kuotat e ish kapitalit shteteror ne shoqerine qe zene shumen 13.653.500 leke, zotit Sotiraq Marjani.

3-Pas ndryshimeve te mesiperme kontributet e ortakeve ne kapital jane: Emanuel Vardhallaqis ka 19% te kapitalit qe perfaqesojne shumën 5.459.000 leke, Panajotis Andoniadhis 18% qe perfaqesojne shumën prej 5.335.500 leke, Nikollaos Andonopullos 18% qe perfaqesojne shumën prej 5.335.500 leke dhe Sotiraq Marjani 13.653.500 leke qe perfaqesojne 45% te vleres se kapitalit te pergjithshem.

4-Administratore te shoqerise do te jene Panajotis Andoniadhis dhe Sotiraq Marjani. Kopetencat e secilit administrator do ti caktoje Asambleja e ortakeve.

EMANUEL VARDHALLAHAQIS

ASAMBLEA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"SUPERBETON"SH.P.K.

NIKOLLAOS ANDONOPULLOS

PANAJOTIS ANDONIADHIS